



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS
OSNOVNI SUD U MITROVICU – BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr.61/2010

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, departamenti i përgjithshëm, e përbërë nga gjyqtari individual Ragip Kadriu, në çështjen juridike kontestimore të paditësit SS nga Mitrovica të cilin e përfaqëson me autorizim Av.RM nga ..., kundër të paditues Komuna e ..., baza e kontestit- pagimi i të ardhurave personale, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë 11.06.2019 jep këtë:

A K T G J Y K I M

OBLIGOHET, e paditura Komuna ... në emer të të ardhurave personale, paditësit SS nga ..., t'ia paguaj për muajt shtator gjer në dhjetor të vitit 2007 shumën prej 357.50 euro, për muajt janar gjer në dhjetor për vitin 2008 shumën prej 1,530.00, për muajt janar, gjer në dhjetor të vitit 2009 shumën prej 1,147.50 euro , me kamatë sipas lartësisë që paguhet për një vit në bankat afariste për mjetet e depozituara pa destinim të caktuar, duke filluar që nga data e ushtrimit të padisë dt.15.03.2010, e gjerë në pagesën definitive të borxhit, të gjitha këto ne afat prej 15 ditësh nga data e nxjerrjes së këtij Aktgjykimi , nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

OBLIGOHET, e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 424.00 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y t i m

Paditësi me padinë e ushtruar, ka kërkuar nga Gjykata që në emër të të ardhurave personale, të e obligoj të paditurën Komuna e, të paguaj shumën totale prej 3,035.00 euro dhe atë me kamatë vjetore për çdo muaj, si dhe shpenzimet e procedurës.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i paditësit deklaroi: Mbetem në tërsi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe precizimit të dhënë me datë 02.07.2018 dhe i propozon gjykatës që të aprovoj në tërsi precizimin dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar si dhe i kërkon shpenzimet e procedurës.

Përfaqësuesi i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaroi: e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë duke theksuar që realisht borxhi i mbetur prej vitit 2007, 2008 dhe 2009 në atë kohë tregu ka qenë nën menagjimin e AKP-së dhe për këtë është e pamundur nga ana financiare të paguhet diçka për të cilën Komuna nuk e

ka menagju në kohen kur paditësit i kanë mbetur borxh lidhur me të ardhurat personale. Kompetencen lidhur me Ndërmarrjet ... i ka fituar pas vitit kur punëtori ka punuar në këtë ndërmarrje realisht është krijuar borxhi ndaj tij. Më tutje deklaron se Komuna e ... nuk mund të paguaj borxh pa pasur kompetencë menagjuese dhe kërkon që gjykata të vendos në bazë të provave dhe ligjit.

Gjykata pas administrimit të provave, të njëjtat i shqyrtoi një nga një, bazuar në nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe atë: ..., Nr.07 e datës 27.01.2010, Kontrata e Punës Nr.... e datës 01.08.2002, Informata ... në Mitrovicë e datës 28.06.2012, Gjykata konstatoi këtë gjendje faktike:

Nuk është kontestuese fakti që te paditësi ka qenë i punësuar te ish tani në kuadër të Komunës së ..., që nga dt.01.08.2002 dhe i njëjti ka punuar gjer me datë 01.01.2010, këtë fakt nuk e ka kundërshtuar asnjëherë e paditura e parë.

Gjithashtu nuk është kontestuese se tani në kuadër të Komunës së ...s, ka lidhë marrëveshje me paditësin me Nr... të datës ..., marrëveshje me të cilën palët janë marr vesh që prej datës e gjer me datë kur edhe paditësi të i mbush moshën ... vjeçare, të i bëhet kompensimin mujor në shumë prej 45.00 euro.

Gjykata vërtetoi se Ndërmarrje në tani në kuadër të Komunës së, me datë, me kërkesën e paditësit e informon dhe nuk e konteston faktin e borxhit të cilin e kanë ndaj palës paditëse.

Gjykata, lidhur me vendosjen sipas pikës 1 të dispozitivit Gjykata u bazuar në nenin 136 par.1, 175 par.1, 245 par.1 dhe par.2 si dhe në nenin 249 par.1 dhe 2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Po ashtu gjykata u bazua edhe në nenin 55 par.1 të Ligjit të Punës (cituar) **1. I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.**

Pretendimet e të paditueses lidhur me atë se Ndërmarrja", ka qenë nën menagjimin e AKP-s, dhe me Vendim të Ministrisë për Zhvillim Ekonomik ka kaluar në kompetencë të Komunës sëdhe tani Komuna I ka 100% kompetencat e saj, për të njëjtat Gjykata thekson se në momentin e marrjes së kompetencave mbi menagjimin e Ndërmarrjes" në, atëherë mbi Komunën e në të njëjtën kohë janë bartuar te drejtat, përgjegjësit dhe obligimet.

Në rastin konkret Komuna është aksionare me 100% të aksioneve në ndërmarrjen në fjalë, e njëjta ka legjitimacion për të qenë palë e paditur sipas nenit 130 të Ligjit për Shoqërit Tregtare, po ashtu obligimi rrjedh edhe në bazë të dispozitave tjera të cituara më lartë që flasin për organizimin, përgjegjësit dhe menagjimin e ndërmarrjeve në fjalë.

Gjykata lidhur me përlogaritjen e kamatës, u bazua në nenin 378 lidhur me nenin 382 par.1 dhe 2 LMD-së, ndërsa lartësinë e saj e caktoi mbi bazën e lartësisë së kamates që paguhet në mjetet e afatizuara në bankat afariste për një vit pa destinim të caktuar.

Gjykata e obligoi të padituren duke u mbështetur në faktin se paditësi marrëdhënien e punës e ka themeluar te Ndërmarrja “.....” në, ndërsa e njëjta me aktin e privatizimit të ndërmarrjes ka kaluar në administrim te e paditura Komuna duke i pranuar të gjitha asetet dhe obligimet.

Gjykata lidhur me vendosjen sipas pikës 11 të dispozitivit për shpenzimet e procedurës, u bazua në nenin 449, 452 par.2 dhe 453 të LPK-së, ndërsa lidhur me vendosjen mbi shpenzimet gjyqësore, u bazua nën nenin 10 par.12, në lidhje me nenin 10.1 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Takave Gjyqësore të KGJK-së nr. 2008/2 dhe përshtatshmerit vendosi që këto shpenzime t’i bartin të paditurit sikurse shpenzimet procedural dhe atë për përpilimin e padisë shumë prej 104.00 euro, për pagesën e taksës gjyqësore Shumen prej 25 euro, për përfaqësim nga I autorizuari në 2 seanca gjyqësore shumë prej 270 euro, ndërsa Gjykatës për përpilimin e Aktgjykimit shumë prej 25 euro.

Gjykata, Aktgjykimin e mbështeti në nenin 143 par.1 të LPK-së

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.61/2010, dt.11.06.2019

GJYQTARI
Ragip Kadriu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.